

RAPORTI TEKNIK

«Shfrytëzimit i mineralit gur gelqerore,Zona nr.121/7 objekti Ferraj», Tirane

»

(Sipas Ligjit nr.10 440 date 07.07.2011 “Per vleresimin e ndikimit ne mjedis”
Shtojca 1,Kodi eshte 19)



Vendndodhja e ushtrimit te aktivitetit : *Zona konkuruese nr 121/7,Objekti « Ferraj », Tirane*

INVESTITOR : “ FERRAJ” Shpk

PROJEKTUES : H&M MINING » PROJEKTE E KONSULENCE

TIRANE 2020

1. PERSHKRIMI I PROJEKTIT

- a. Qellimi i projektit te propozuar
- b. Planimetria e vendodhjes se projektit , ku te pasqyrohen ne harte topografike kufijte e siperfaqes se tokes se kerkuar,te shoqeruar me koordinatat sipas sistemit GAUSS KRUGER, fotografi dhe te dhena per perdorimin eksiztues te siperfaqes se tokes qe do te perdoret perkohesisht apo perhere nga projekti gjate fazes se ndertimit apo instalimit te pajisjeve
- c. Informacion per qendrat e banuara, ne zonen ku propozohet te zbatohet projekti, shoqeruar me fotografi dhe te dhena per distancen e tyre nga vendodhja e projektit te propozuar, si dhe percaktimin e njesise se qeverisjes vendore qe administron territorin ku propozohet projekti
- ç. Skicat dhe planimetrite e objekteve te projektit dhe strukturave te projektit
- d. Pershkrim i proceseve ndertimore dhe teknologjike te shfrytezimit te gurit gelqerore me kariere, perfshire kapacitetin prodhues, sasite e lendeve te para dhe produktet perfundimtare te projektit.
- e. Infrastruktura e nevojshme per lidhjen me rrjetin elektrike, furnizimin me uje, shkarkimet e ujerave te ndotura dhe mbetjeve si dhe informacion per rruget ekzistuese te aksesit apo nevojen per hapje te rrugeve te reja
- f. Programi per ndertimin, kohezgjatjen e ndertimit, kohezgjatjen e planifikuar te funksionimit te projektit, kohen e mundshme te perfundimit te funksionimit te projektit dhe sipas rastit edhe fazen e planifikuar te rehabilitimit te siperfaqes pas mbarimit te funksionimit te projektit
- g. Menyrat dhe metodat qe do te perdoren per ndertimin e objekteve te projektit
- h. Lendet e para qe do te perdoren per ndertimin dhe menyra e sigurimit te tyre (materiale ndertimi, uje, energji)
- i. Informacion per lidhjet e mundshme te projektit me projekte te tjera ekzistuese perreth/prane zones te projektit
- j. Informacion lidhur me alternativat e marra ne konsiderate persai takon perzgjedhjes se vendodhjes se projektit dhe teknologjise qe do perdoret
- k. Perdorimin e lendeve te para gjate funksionimit, perfshire sasite e ujit te nevojshme , energjise, lendeve djegese dhe menyren e sigurimit te tyre
- l. Aktivitete te tjera qe mund te nevojiten per zbatimin e projektit , si ndertim i kampeve apo rezidencave etj.
- m. Informacion per lejet dhe licensat e nevojshme per projektin te kerkuara nga legjislacioni ne fuqi si dhe institucionet kompetente per lejimin/licensimin e projektit
- k. kopje te lejeve, autorizimeve dhe licencave qe disponon zhvilluesi per projektin e propozuar , ne perputhje me percaktimet e bera ne legjislacionin ne fuqi, si dhe institucionet kompetente per lejimin/autorizimin/licencimin e projektit.

HYRJE

Shoqëria “**FERRAJ**” shpk është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në fushën e aktivitetit për shfrytëzim përpunim në qiell të hapur (kariera) dhe tregtim të lendeve minerare të grupit të IV etj.

Shoqëria “Ferraj” sh.p.k, ka objekt të aktivitetit të saj kryerjen e punimeve të ndryshme ka marrë pjesë në konkurimin e zhvilluar me datë 28.05.2020 për fitimin e së drejtës për pajisje me lje minerare shfrytëzimi në objektin e gurit gelqeror , zona minerare konkurruese nr 121/7 Ferraj Tirane, dhe me shkresë të Ministrisë së Infrastrukturas dhe Energjisë nr. 4792/2 Prot, datë 10.08.2020, është shpallur fitues dhe është njoftuar nga Ministria e Infrastrukturas dhe Energjisë të për të aplikuar për marrjen e lejes minerare të shfrytëzimit në zonën minerare nr 121/7 Ferraj, Tirane

Në Shqipëri fillimet e legjislativitetit mjedisor shfaqen në vitin 1993 , vit në të cilin u hartua plani i parë i veprimit në fushën mjedisore, që përben dokumentin e parë zyrtar shqiptar mbi politikën mjedisore në vend. Ky plan veprimi kombëtar parashikonte se qeveria duhet të krijojë kuadrin ligjor , ekonomik dhe institucional për zgjidhjen e çështjeve mjedisore. Periudhën nga ky vit deri në miratimin e Kushtetutës në vitin 1998 mund ta konsiderojmë si etapën e parë të zhvillimit të së drejtës shqiptare të mjedisit. Mbas vitit 1998 e në vijim është periudha e dytë e zhvillimit të së drejtës shqiptare të mjedisit, e cila ka si tipar kryesor prirjen e përafërimit me legjislativitetin e Bashkimit Europian për mjedisin. Kuadri ligjor mjedisor shqiptar është në përsosje dhe pasurim të vazhdueshëm dhe zhvillimi i tij nuk i është len rasteies, por ka si model dhe drejtues legjislativitetin europian të mjedisit. Duke qenë se kushtetutat ravigjezojnë drejtëtimet e rregullimeve të ardhshme dhe me të hollësishme që realizohen fillimisht me ligje dhe me pas me akte nenligjore edhe në rastin e vendit të Kushtetutës përben një fillesë dhe bazë të rëndësishme lidhur me rolin që ka mjedisi për shoqërinë dhe shtetin të. Nisur nga përmbajtja e nënve të Kushtetutës lidhur me fushën mjedisore mund të pohojmë se fryma e Kushtetutës sone është në përputhje me atë të shumë kushtetutave të vendeve të tjera demokratike që u kushtojnë rëndësi të një niveli me të lartë disa parimeve mjedisore, duke i ngritur ato në nivelin e ligjit themelor të shtetit, sic janë e drejta për informimin e qytetarëve dhe angazhimi e përgjegjësia për një mjedis të përshatshëm për të jetuar jo vetëm brezat e sotëm por edhe ata në të ardhmen.

Legjislacioni mjedisor

- VKM nr.686 date 29.7.2015 « *Per miratimin e rregullave , te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis (VNM) dhe procedures se transferimit te vendimit e Deklarates Mjedisore »*
 - Ligj nr 12/2015 per disa ndryshime ne ligjin nr. 10440 date 07.07.2011 « *Per vleresimin e ndikimit ne mjedis »*
 - VKM nr. 435 date 12.09.2015 « *Per miratimin e normave te shkarkimeve ne ajer ne Republiken e Shqiperise »*
 - VKM nr. 575 date 24.06.2015 “*Per miratimin e kerkesave per menaxhimin e mbetjeve inerte*”
 - VKM nr.419 date 25.6.2014 « *Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A,B dhe C per transferimin e lejeve nga nje subject te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mjedisit si dhe rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKLja.*
 - Vendim Nr. 247, datë 30.4.2014 “*Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore*”
 - Vendim nr. 13 date 4.1.2013 « *Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis »*
 - VKM nr. 765 date 07.11.2012 “*Per miratimin e rregullave per grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave te perdorura*”
 - Ligji Nr.10 431, date 09.06.2011 “ *Per Mbrojtjen e Mjedisit*”
 - Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “*Per menaxhimin e integruar te mbetjeve*”
- Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 « *Per Lejet e Mjedisit »*
- Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 « *Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis »*
 - Ligj Nr 10304, datë 15.7.2010 “*Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë*”.
 - Ligj nr. 10266 date 15.04.2010 “*Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja*” per disa ndryshime dhe shtesa ne Ligjin nr. 8897 dt. 16.05.2002 “*Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja*”
 - Udhëzimin nr.12 date 15.06.2010 per disa ndryshime ne Udhëzim nr. 6527 date 24.12.2004 “*Mbi Vlerat e lejueshme te elementeve ndotes te ajrit ne mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkaktuar nga mjetet rrugore dhe menytrat e kontrollit te tyre*”
 - Urdhri e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 “*Per miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes*”
 - Udhëzimin nr 8 dt. 27.11.2007 “*Per nivelin kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara*”
 - Udhëzim Nr 3, datë 17.05.2006 “*Për planet e rehabilitimit të sipërfaqeve të dëmtuara nga guroret*”
 - VKM. Nr 177, datë 31.03.2005 “*Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse*”.
 - Ligji Nr 9385, datë 04.05.2005 “*Për pyjet dhe shërbimin pyjor*”. të ndryshuar dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij.

H&M MINING

PROJEKTE E KONSULENCE

BLLOKU”Vasil Shanto”

Rr. Viktor Eftimiu,P.1, Shk.5, Ap.2

Email:dhuro_caushi@yahoo.com

- Ligji Nr 9115, datë 27.02.2003 *“Për trajtimin mjedisor të ujrave të ndotur”*. Të ndryshuar dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij.
- Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 *“Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”*
- Ligji Nr 8906, datë 06.02.2002 *“Për zonat e mbrojtura”*. të ndryshuar dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij.
- Ligj nr. 8094 date 21.03.1996 « *Per largimin publik te mbeturinave* »

a. Qellimi i projektit te propozuar

Qellimi i projektit te propozuar nga shoqëria "Ferraj" sh.p.k është shfrytezimi i gurit gelqeroreme kariere me punime siperfaqesore , objekti zona minerare konkurruese nr.121/7,objekti Ferraj rrethi Tirane, per nxjerrjen e mineralit tegurit gelqeror qe sherben si lende e pare ne industrine e ndertimit.

Kjo zone është e ofron kushte lehtësuese për shfrytezimin e gurit gelqerore me kariere me punime siperfaqesore sepse është nje zone large qendrave te banuara, kun prek vepra te veçanta dhe nuk bene pjeswe ne ndonje zone te mbrojtur rruge per ne objekt jan pothuaj te hapura dhe me pake punime mund te fillohet nga aktivitetit. Nga pikpamja gjeografike terreni ku ndodhet objekti per shfrytezim « guri gelqeror » është terren kodrinor.

Shoqëria “Ferraj” sh.p.k, ka objekt te aktivitetit te saj kryerjen e punimeve te ndryshme ka marre plese ne konkurimin e zhvilluar me date 28.05.2020 per fitimin e se drejtes per pajisje me lje minerre shfrytezimi ne objektin e gurit gelqeror , zona minerare konkurruese nr 121/7 Ferraj Tirane, dhe me shkrese te Ministrise se Infrastruktures dhe Energjise nr. 4792/2 Prot, date10.08.2020,është shpallur fitues dhe është njoftuar nga Ministria e Infastruktures dhe Energjise te per te aplikuar per marjen e lejes minerare te shfrytezimit ne zonen minerare nr 121/7 Ferraj, Tirane

Persa i perket referencave per harta kadastrale pyjore keto do ti paraqiten Ministrise se Mjedisit pasi shoqëria pajiset me leje mjedisore dhe fillojne procedurat per heqjen nga fondi pyjor ne baze te vendimit nr.1374 date 10.10.2008 Per percaktimin e rregullave dhe te procedurave qe ndiqen per heqjen, shtimin dhe ndryshimin e detinacionit te fondit kullisor, vendim nr.435 date 8.6.2016 Per disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin nr.1374 date 10.10.2008 te Keshillit te Ministrave “Per percaktimin e rregullave dhe te procedurave, qe ndiqen per heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit te fondit Kullisor”, Vendim nr.1353 date 10.10.2008 Per percaktimin e rregullave per paraqitjen e kerkeses, mbajtjen dhe plotesimin e dokumentacionit teknik si dhe te kriterëve te procedurave te zvogelimit te siperfaqes e te vellimit te fondit pyjor, Vendim nr. 434 date 8.6.2016 Per disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin nr.1353 date 10.10.2008 te keshillit te ministrave Per percaktimin e rregullave per paraqitjen e kerkeses , mbajtjen dhe plotesimin e dokumentacionit teknik si dhe te kriterëve e te procedurave te zvogelimit te siperfaqes e te vellimit te fondit pyjor”

H&M MINING

PROJEKTE E KONSULENCE

BLLOKU”Vasil Shanto”

Rr. Viktor Eftimiu,P.1, Shk.5, Ap.2

Email:dhuro_caushi@yahoo.com

b. Planimetria e vendodhjes se projektit , ku te pasqyrohen ne harte topografike kufijte e siperfaqes se tokes se kerkuar,te shoqeruar me koordinatat sipas sistemit GAUSS KRUGER, fotografi dhe te dhena per perdorimin eksistues te siperfaqes se tokes qe do te perdoret perkohesisht apo perhere nga projekti gjate fazes se ndertimit apo instalimit te pajisjeve

Projekti i hartuar ka per qellim studimin e mundesise se shfrytezimit te gelqeroreve te objektit “Ferraj” , Komuna Dajt rrethi Tiranë nga subjekti privat, “FERRAJ” shpk qe ka paraqitur kerkesen per marjen e lejes minerare te shfrytezimit

Per hartimin e studimit tekniko-ekonomik dhe projektit te shfrytezimit te ketij objekti jane mare ne konsiderate :

1. Pozicioni gjeografik dhe mardheniet e objektit me qendrat e banuara
 1. Topografia dhe klima e zones ne te cilen ndodhet objekti i marre ne konsiderate
 2. Hidrologjia dhe hidrografia e zones ne te cilen kufizohet objekti i shfrytezimit .
 3. Hidrogeologjia zones ne te cilen kufizohet objekti i shfrytezimit, mundesia e daljes se burimeve te ndryshme brenda zones se shfrytezimit dhe parandlimi i pasojave te tyre ne procesin e shfrytezimit .
 4. Klima rreshjet dhe intensiteti i tyre si nje faktor i rendesishem gjate ushtrimit te aktivitetit minerar
 5. Gjendja e infrastruktures se rajonit ne pergjithesi dhe te zones se objektit , mundesite e permiresimit te saj, ndertime dhe instalime te tjera te domosdoshme per shfrytezimin e objektit nga pikpamja minerare.
 6. Materiali gjeologjik baze lidhur me ndertimin gjeologjik te rajonit dhe objektit, sasine dhe cilesine e rezervave gjeologjike dhe te shfrytezueshme brenda kufijve te percaktuar te shfrytezimit
 7. Matjet dhe dokumentimet e ndyshme te kryera ne teren lidhur me vetite gjeomekanike, karakteristikat fiziko-mekanike dhe parametrat gjeoteknike te formacione, qe ndertojne vendburimin, te cilat mund te kufizojne ne menyre te natyrshme permasat e blloqeve shkembore ne siperfaqe dhe thellesi te objektit dhe te detyrojne perdorimin e menyrave te pershateshme te rrezimit te gurit gelqeror
 8. Kerkesa te ndryshme per makineri, pajisje dhe investime te tjera per pergatitjen dhe shfrytezimin e objektit.
 9. Respektimi i Rregullores se Teknikes se Sigurimit ne Karierra dhe mbrojtja e zonave te banuar per rreth si dhe mjedisit .
 10. Llojet e produkteve te prodhuara dhe tregu i shitjes se tyre

1.2 Vendndodhja e objektit

1. Gjeografia e zonës, Relievi, klima, bimësia,

Gjeografikisht, objekti i kërkuar në luginën e lumit të Tjiranes, në krahun e djathtë të rrjedhës së mesme të tij në lindje të fshatit Brar, rreth 1.2 km, në jug kufizohet nga periferia e fshatit Ferraj në veri perëndim rreth 1.5 në vije ajrore shtrihet lahja e sipërme e fshatit Zall-Herr në krahun e majtë të perroit të Qershise dhe në verilindje vendoset kodra e Papatit me lartësi 493.5 m mbi nivelin e deti



Pamje nga afer e formacioneve gelqerore të zonës

Rilevimi të zonës që kërkohet është përgjithësisht kodrinor dhe vendoset poshtë rrëzimit të malit të Papatit, përgjithësisht i çveshur dhe pa ndonjë bimësi të zhvilluar, largë objekteve të banimit dhe rrugës auto. Brënda zonës nuk ka objekte banimi, apo të rëndësishme të veçant.


Nga pikpamja topografike vendoset në sipërfaqen me koordinata si në tabelën më poshtë:

Koordinatat e zonës nr. 121/7, Ferraj

Pika	Y	X
1	44 04 171	45 84 991
2	44 04 136	45 85 230
3	44 04 304	45 85265
4	44 04 355	45 85 029

Sipërfaqja e zonës në planin horizontal është 0.043 km²

FERRAJ SH.P.K



H&M MINING
PROJEKTE E KONSULENCE
BLLOKU "Vasil Shanto"
Rr. Viktor Efimiu, P.1, Shk.5, Ap.2
Email: dhuro_caushi@yahoo.com




Pamje e pjeseshme e rruges per ne objekt, hapur kohe me pare

Kjo zone eshte e papyllezuar, pa objekte banimi e industriale dhe nuk gezon ndonje status te vecante. Objekti eshte i lidhur me rrugen ekzistuese nacionale. Zona nuk ka ndonje perdorim te vecante ,eshte shfrytezuar nga shoqeria per nxjerrjen e gurit gelqeror. Ne perfundim te aktivitetit kjo zone do te rehabilitohet dhe do ti kthehet funksionit te meparshem te saj dhe perdorimit nga banoret e zones per kullote.

c. Informacion per qendrat e banuara, ne zonen ku propozohet te zbatohet projekti, shoqeruar me fotografi dhe te dhena per distancen e tyre nga vendodhja e projektit te propozuar, si dhe percaktimin e njesise se qeverisjes vendore qe administron territorin ku propozohet projekti

Gjeografikisht, objekti i kerkuar ne luginen e lumit te Tiranes, ne krahun e majte te rruges se re te Arberit ,ne krahun e djathte te rrjedhes se mesme te tij ne lindje te fshatit Brar, rreth 1.2 km, ne jug kufizohet nga periferia e fshatit Ferraj ne veri perendim rreth 1.5 ne vije ajrore shtrihet lagjja e siperme e fshatit Zall-Herr ne krahun e majte te perroit te Qershise dhe ne verilindje vendoset kodra e Papatit me lartei 493.5 m mbi nivelin e detit. Nga pike[amja administrative, i perkete njesise vendore Dajtit dhe i perket rrethit te Tiranes Qendrat e tjera te banuara jan qyteti i Tiranes ne jug te zones, fshatr\|t e Tufines dhe me ne perndim shtrihen lagjet periferike te Kamzes

FERRAJ SH.P.K



H&M MINING
PROJEKTE E KONSULENCE
BLLOKU "Vasil Shanto"
Rr. Viktor Eftimiu, P.1, Shk.5, Ap.2
Email: dhuro_caushi@yahoo.com

FERRAJ SH.P.K



Foto Rruga e Arberit



Lagje e Brarit, periferia e Tiranës

ç. Skicat dhe planimetritë e objekteve të projektit dhe strukturave të projektit

Objekte në shërbim të aktivitetit do të jetë konteneri që përdoret për shfrytëzimin e objektit.

d. Përshkrim i procesit ndërtimor dhe teknologjik, përfshirë kapacitetet prodhuese/perpunuese, sasitë e lendeve të para dhe produktet përfundimtare të projektit

Duke marrë në konsideratë elemente si: prodhimin e projektuar, topografinë e terrenit të objektit të projektuar, sasinë e rezervave të shfrytëzueshme, karakteristikat gjeomekanike të shkëmbinjve, elementet e shtruarjes dhe koeficientin e zbulimit, është parashikuar shfrytëzimi i gurit gelqeror të behet me punime sipërfaqësore me **kariere**.

Shfrytëzimi me qiell të hapur i gurit gelqeror favorizohet dhe nga këto faktore:

Renia e formacioneve, që ndertojnë pakon produktive në drejtim të tillë që lejojnë zhvillimin normal të shkalleve dhe elementeve të tyre pa sjellë kushte të teknike.

Ekspierienca e shfrytëzimit të viteve të kaluara në objekte të njëjta ka treguar se elementet e shtruarjes së formacioneve gur gelqeror dhe karakteristikat gjeomekanike të tyre favorizojnë këndet deri 75° të skarpave dhe nuk sjellin asnjë rrezik rreshqitje.

Hidrografia e zonës, në përgjithësi dhe territori i projektuar për leje minerare në veçanti, nuk pritet të krijojë probleme për shfrytëzimin e vendburimit, mbasi sipërfaqja është plotësisht e drenuar dhe nuk ka probleme ujërash dhe burimesh të pranishme në të.

Në vendburim nuk ka burime të ujërave, apo vepra ujore të ndërtuara nga njeriu, etj, ato nuk janë të pranishme në zonën e shfrytëzimit dhe për rreth saj.

Aktiviteti do të kryhet në kufijt e lejes minerare.

-Kapaciteti Prodhuës

Prodhimi i gelqeroreve nga shfrytëzimi i këtij vendburimi në zonën e kerkuar do të ketë si destinacion përdorimin e tij në industrinë e ndërtimit të qytetit Vlorë në formë të gureve të prodhuar direkt nga karriera dhe të materialit të përpunuar si rere, granit apo çakell. Për këto arsye, në varesi të tregut të studjuar dhe të pritshëm, sipas përcaktimeve të bëra në akt miratimit të lejes minerare parashikohet një prodhim vjetor 25000 m³/vit, nga do të trajtohet për prodhim material inert I cili do të përpunohet në impiant thyerje dhe fraksionimi.

Gjithësesi pavarësisht kësaj, objekti ka sipërfaqe dhe rezervë të mjaftueshme për të përballuar çdo mundësi rritje të kapacitetit prodhuës i cili në çdo rast është në vartësi të kërkesave të tregut të Vlores dhe për rreth.

Regjimi i punës

Për realizimin e prodhimit të parashikuar karriera do të punojë gjatë gjithë vitit 240 ditë në vit, 25-26 ditë në muaj me një ndërëse në ditë.

Grafiku i zbulimit dhe prodhimit

H&M MINING

PROJEKTE E KONSULENCE

BLLOKU "Vasil Shanto"

Rr. Viktor Eftimiu, P.1, Shk.5, Ap.2

Email: dhuro_caushi@yahoo.com

Sasia e pergjitheshme e zbulimit te kesaj karriere eshte 4640 m3 parashikohet te realizohet progresivisht dhe paralelist me shfrytezimin

Volumi i pergjithshem i zbulimit, i cili do te kryhet ne vite te ndryshme do te depozitohet perkohesisht ne pjesen anesore te shkalleve dhe ne perfundim te shfrytezimit do te depozitohet ne shkalle sipas planit te rehabilitimit te objektit, ne sheshin e krijuar nga shfrytezimi ne vitet e pare brenda kufijve te shfrytezimit .

Me varjantin e propozuar te shfrytezimit, ne project eshte parashikua qe te prodhohen rreth 2000 m3 blloqe dhe pjesa tjeter te trajtohet si material inert ose gure themeli material inert .

Pra nga aktiviteti ne objekt parashikojme qe te prodhohen 25000 m3 gure gelqeror per material inert

FERRAJ SH.P.K

Grafiku i prodhimit ne shkalle ne vite

shkalla	sip, m2	s mes	h, m	vol, m3	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	Shuma
340	3173	2115		2115	2115																									2115
330	6174	4673.5	10	46735	2885	10000	20000	13850																						46735
320	9910	8042	10	80420			5000	11150	15000	15000	20000	14270																		80420
310	13422	11666	10	116660					10000	10000	5000	10730	15000	15000	15000	15000	15000	5930												116660
300	16751	15086.5	10	150865									5000	10000	10000	10000	10000	19070	15000	15000	15000	15000	15000	11795					150865	
390	20255	18503	10	185030															10000	10000	10000	10000	10000	13205	15000	15000	15000	15000	15000	138205
280	23500	21877.5	10	218775																				10000	10000	10000	10000	10000	50000	
				800600	5000	10000	25000	25000	25000	25000	25000	25000	20000	25000	25000	25000	25000	25000	25000	25000	25000	25000	25000	25000	25000	25000	25000	25000	25000	585000

Variantet e hapjes se vendburimit, argumentimi dhe zgjedhja e menyres se hapjes se vendburimit.

Meqenese shfrytezimi i vendburimit do te behet me kariere, hapja dhe pergatitja e rezervava te shfrytezueshme do behet me punime siperfaqore dhe rruge auto qe do te ndertohen ne fushen minerare.

Projekti i hapjes se karieres, zgjidh detyren e lidhjes se saj me rrugen kryesore te transportit, nga miniera ne destinacion i cili mund te jete impiant thyerje –fraksionimi apo perdorim direkt si material mbushes

Per hartimin e projektit te hapjes se karieres u mbeshitetem ne elementet e me poshtem:

- Lartesia e projektuar e shkalles,
- Elementet e shtrirjes e te renies se gelqeroreve ne fushen minerare,
- Vetite fiziko-mekanike te gurit gelqeror,
- Relievin ne zonen e vendburimit e pe rreth, rruget ekzistuese te transportit, vendndodhjen e impjantit te coptimit, etj.
- Llojin e transportit, mjetet e ngarkimit, te shpimit dhe menyren e rrezimit te shkembit,
- Sasine e rezervave ne venburim,
- Prodhimin vjetor te planifikuar per shfrytezim.

Projekti i shfrytezimit parashikon :

- Punimin e hapjes i cili do te ruhet gjate gjithe kohes se shfrytezimit.
- hapjen e punimeve pergatitore per cdo shkalle, nga kuota +370 , duke u ulur ne kuoten +310.
- Varianti i hapjes eshte lidhja me e shkurter e fronteve te shfrytezimit te gurit gelqeror me konsumatoret.

Mbas marjes ne konsiderate te faktoreve te mesiperm eshte bere studimi i varianteve te hapjes se vendburimit dhe eshte konkluduar se ai mund te hapet nga ana e rruges automobilistike qe lidh fshatin Brar me qytetin e Tiranës

Nga verifikimi ne vend i varjnteve te mundshem per hapjen e objektit eshte pare e mundsur qe fillimi i punes ne zone te realizohet nga rruga e hapur ne jug te fshatit Ferraj e cila ne gjithe gjatesine e saj eshte e hapur, pjaserish e asfaltuar dhe pjaserisht rruge gjysem e hapur e cila me pak shpenzime riparimi behet e mundur te perdoret per fillimin e punes Vetem rreth 200 metra rruge e re mbeet per tu hapur deri ne oobjekt dhe behet i mundur nisja e investimeve per objekte industriale,

Kjo rruge eshte rreth 4 km me e gjate se rruga tjeter ne krahun veriore te fshatit, eshte me e shkurter , por kerkon hapje te nje rruge te re

H&M MINING

PROJEKTE E KONSULENCE

BLLOKU"Vasil Shanto"

Rr. Viktor Eftimiu,P.1, Shk.5, Ap.2

Email:dhuro_caushi@yahoo.com

Pika e fillimit te transhese do te jete ne nje disatence te afert nga kufiri i karrieres 1-5 duke filluar nga pika "A" prane Ures se Brarit me koordinata $y=4405050$, $X= 4584300$ e cila pjeserish eshte e hapur dhe pjesa ne nje gjatesi prej 400 m dhe me tej ne vijim do te hapet rruge e re me gjaresi 450 m deri ne nivelin e siperm te karrieres +342 duke prere izoipset e shkalleve te mesiperme

Gjatesia e rruges sipas ketij aksi nga niveli actual i saj deri ne kuoten +342 rezulton rreth 950m

Hapja e vendburimit deri ne kuoten +342m parashikohet te behet me nje rruge me gjeresi 6-m dhe pjerresi 12-14% . Gjatesia e pergjitheshme e kesaj rruge duke perfshire dhe kthesat parashikohet te jete rreth 1.0 km .

Projekti i hapjes se karrieres i bashkangjitet materjalit.

Disniveli midis kuotes se siperm dhe pikes me te poshteme eshte rreth 60 m.

Dyshemeja e kesaj transheje do te shtrohet me çakell qe do te prodhohet gjate hapjes se transhese se brendeshme.

Transheja e hapjes se brendeshme do te kaloje kryesisht ne formacione te forta, (gelqerore) prandaj hapja e saj do te behet me perdorimin e punimeve shpim-plasese dhe forces mekanike te koves se eskavatorit dhe buldozerit.

Me lidhjen e rruges ne shkallen e siperm +342m ne kuoten me te siperm do te filloje hapja e transhese preres ne ate shkalle dhe paralelisht me shfrytezimin ne te, do te vijojte te hapet kjo transhe nga larte –poshte duke filluar nga kuota +330 ne +320 pastaj ne kuoten +310e me radhe. Keto transhe do te hapen horizontale duke ndjekur izoipsin ne horizontin perkates. Gjeresia e ketyre transheve do te jete e njejte me ate te transhese kryesore (te hapjes) te brendeshme. Drejtimi i hapjes se transhese preres do te jete nga lindja ne perendim dhe anasjelltas ne varesi te vendit te hapjes se saj nga transheja kryesore.

Sistemi i shfrytezimit treguesit tekniko-ekonomike te tyre.

11. Ne zgjedhjen e sistemit te shfrytezimit jane mare parasysh faktoret e meposhtem:
12. Menyra e ngarkimit dhe transportit te sterilit
13. Menyra e kryerjes se punimeve te zbulimit
14. Menyra e ngarkimit dhe transportit te gurit gelqeror ne brendesi te karrieres dhe jashte saj
15. Ngarkimi i gurit gelqeror ne te gjitha sheshet e karrieres parshikohet te kryhet me eskavator me kove $1.5-2 \text{ m}^3$

Bazuar ne sa me siper, sistemi i shfrytezimit qe parashikohet te perdoret eshte i thjeshte me transport te sterilit ne distance deri 0.5 km, duke lejuar ne kete menyre depozitim e sterilit ne afersi te karrieres ne sejcilen shkalle, ne brendesi te zones se kerkuar per shfrytezim. Ne vizatimin planimetria karrieres ne fund te shfrytezimit ne shkalle te ndryshme eshte paraqitur

depozita e sterileve. Ne perfundim te shfrytezimit, ket sterile do te depozitohen ne sheshet e shkalleve , do te mbulohen me toke vegetale dhe do te mbillen me peme dru frutore.

Elementet e sistemit te shfrytezimit qe parashikohet te perdoret ne kete objekt jane

Lartesia e shkalles se karrieres eshte 10m

Gjeresia e sheshit te punes nga 8-12 m ne 20-40m

Kendi i skarpates se shkalles ne gjendje pune 68-70°

Kendi i shuarjes se skarpates se shkalleve 63°

Gjeresia e shesheve perfundimtare te shkalleve 3 m

Kapaciteti ditor 160 m³

Bartja dhe transporti i mekanizuar;

Rezimi i i gurit gelqeror me perdorimin e lendes plasese

3.6. Rradha dhe drejtimi i shfrytezimit dhe grafiket perkates te tyre

a) Rradha dhe drejtimi i shfrytezimit

Sikunder duket edhe nga terreni, ne afersi te objektit kalone rruge e kategorise se katert. Nga kjo rruge do te devijohet ne drejtim kuotes se siperme +342 , dhe mandej do te mbrij ne nivelet e shkalleve +3300 dhe +320m ne trajte serpentine dhe nen te do te hapen transhete prerese per formimin e shkalleve ne çdo 10 m disnivel per fillimin e shfrytezimit te objektit.

Meqenese shfrytezimi i objektit do te fillohet nga nivelet e siperme, atehere edhe shkallet e siperme do te lidhen me rrugen per ne objekt. Kjo rruge do te hapet nga subjekti mbas marrjes se lejes minerare me parametrat e kerkuar per levizje mjetesh te renda Paralelisht me hapjen e kesaj rruge dhe ndertimet industriale te nevojshme, do te vijohet me hapjen e rruges per lidhjen e niveleve te siperme me ate te poshteme me transhene e brendeshme.

Zbankimet qe do te behen ne kete nivel do te krijojne sheshin e depozitimit te sterileve qe megjithese te pakta, kerkojne shesh depozitimi.

Pas kryerjes se zbulimit ne nivelin e shkalles +342 ne vitin e pare, hapjes se rruges per ne shkallet +330 dhe +320m ne te gjithe gjatesine e zones se shfrytezimit, kryerjes se skarifikimeve, gerimeve dhe sistemimeve te ndryshme, parashikohet te filloje dhe prodhimi i gurit gelqeror ne sasine e prej rreth 5000 ton deri ne kapacitetin e projektuar prej rreth 25000m³)

Drejtimi i shfrytezimit Drejtimi shfrytezimit te objektit do te jete pergjithesisht nga kufi lindor per ne perendim drejt nivelit fundor te objektit

Orjentimi i pergjithshem i shkalleve do te jete sipas izohipseve te terenit (shih planimetrine e karrieres ne gjendjen perfundimtare, vizatimi Nr. 6) nga lindja per ne perendim

b) Elementet geometrike te karrieres ne gjandje perfundimtare

H&M MINING

PROJEKTE E KONSULENCE

BLLOKU"Vasil Shanto"

Rr. Viktor Eftimiu,P.1, Shk.5, Ap.2

Email:dhuro_caushi@yahoo.com


Duke pasur parasysh pozicionin gjeografik te karrieres, relievin dhe parametrat gjeometrike te shkalleve, karriera do te kete formen e nje stadiumi me zgjatje Juge Veri , me parametrat e me poshtem

16. Thellesia e vertikale e karrieres, 52 m
17. Numuri i shkalleve 6;
18. Kendi i shuarjes se shkalleve ne varesi te shtrirjes se karrieres eshte 63
19. kendi i pjerresise se skarpatave te shkalleve 68-73⁰
20. Lartesia e shkalles 10m;
21. Orientimi i transheve te hyrjeve eshte nga kryq terrenit nga lindja drejt perendimit nga qendra per ne periferi (ne varesi te mbritjes se transhese kryesore)

Rrezimi i formacioneve shkembore

Rrezimi i shkembinjeve gelqerore do te realizohet me nje nga metodat e njohura me bira te shkurtra marteli, me puse sonde, dhe rrezimi me dhoma minash, metoda te cilate mund te aplikohet ne objekt

FERRAJ SH.P.K



H&M MINING
PROJEKTE E KONSULENCE
BLLOKU "Vasil Shanto"
Rr. Viktor Eftimiu, P.1, Shk.5, Ap.2
Email: dhuro_caushi@yahoo.com

FERRAJ SH.P.K

Parashikimi i puneve te shpim plasjes eshte bere duke patur parasysh faktoret e meposhtem:

Domosdoshmerine e perdorimit te Lendes Plasese per rrezimin e gelqerorit;

Volumin ditor do te jete 110 m^3 ;

Shpimi i birave ne pjeset fillestare te hyrjes ne shkalle dhe ne hapjen e transheve te cekta do te behet me cekic shpues pneumatik dore;

Ne mometin e kryerjes se zbulimit ne shkallet e formuara me lartesi 10 m parshikohet te perdoret rrezimit me puse sonde ;

Me poshte jane dhene pasaporta e shpim plasjes per te tre rastet e rrezimit.

Pasaporta e shpim plasjes me bira te shkurtra dore

Parametrat e kesaj shpim plasje e cila do te perdoret gjate hapjes se rruges apo kryerjes se ndonje germimi e sistemimi te nevojshme do jene si me poshte (shif pasaporten e shpim plasajes)

Lartesia maksimale e germimit	3-5 m
Gjatesia e bires	2.2ml
Diametri i bires	38-42 mm
Kendi i skarpates	63-65°
Distanca nga bira ne bire	1.5 m
Distanca nga buza e skarpates ne bire	1.2 m
Vija e rezistences me te vogel	2-2.2 m
Ngarkesa e Lendes Plasese per bire	1.8 kg
Volumi maksimal i hedhur bire	6 m ³
Konsumi specifik i lendes plasese	0.35 kg /m ³ masiv

Birat do te jene vertikale

Per mbushjen e birave parashikohet te perdoret amonit malor .

Ne rastet e rrezimit me bira sondash parametrat e pasaportes se shpim plasjes do te jene si me poshte (shif pasaporten e shpim plasajes me puse sondash)

Lartesia e shkalles	10 m
Gjatesia e bires	11ml
Diametri i pusit te sondes	100 mm
Kendi i skarpates	68-73°

H&M MINING

PROJEKTE E KONSULENCE

BLLOKU"Vasil Shanto"

Rr. Viktor Eftimiu,P.1, Shk.5, Ap.2

Email:dhuro_caushi@yahoo.com

"FERRAJ" SH.P.K

Distanca nga bira ne bire	3 m
Distanca nga buza e skarpates ne bire	3.5 m
Vija e rezistences me te vogel	6- 6.5 m
Ngarkesa e Lendes plasese per bire	68.25 kg
Volumi mesatar i hedhur per pus sonde	240-260 m ³
Konsumi specifik i lendes plasese	0.35kg /m ³ masiv

Birrat do te jene vertikale

Ne raste te pershtateshme mund te perdoren dhe bira te pjerrta me kend pjerresie 75°

Sasia e lendes plasese per 1 pus sonde eshte llogaritur si me poshte :

$$Q = 0.34x axWxH = 0.35x 3 x 6.25 x 10 = 64 \text{ Kg}$$

Ku:

Q -Sasia e L.P per cdo pus sonde ne Kg

0.34 -Koeficient praktik i eksperiencs ne formacione analoge te zones

a - Distanca midis birave ne ml 3 ml

W - Vija e rezistences me te vogel 6-6.5 m

H - Lartesia e shkalles 10 m

Volumi i pritshem qe do te zhvendoset pas shperthimit te 10 puseve te sondes do te jete 3800-4000 m³ te shkrifet

Parametrat e mesiperme te pasaportave te shpim plasjes jane orientues, te bazuar ne eksperiencen e kryerjes se puneve me lende plasese ne guroret dhe karrierat e ndryshme te rajonit ne shkembinj me karakteristika te peraferta dhe mund te korigjohen gjate kryerjes se punimeve faktike te shpim plasjes ne kushtet reale te karrieres sone

Ne mbushjen e birave me lende plasese mund te perdoret, pervec amonitit malor, dhe ANFO, **duke zbatuar ligjin e te drejtes se prodhimit te lendes plasese, e cila jepet me leje te posacme nga Ministria e Mbrojtjes** .

Percaktimi i kufijve te zonave te parrezikshme nga punimet e shpim plasjes

Per pune te sigurte ne perputhje me Rregullat e Teknikes se Sigurimit per Punet me Lende Plasese, personeli teknik i karrieres eshte i detyruar te respektojte distancat e parrezikshme te llogaritura me poshte :

1.Percaktimi i largesise se sigurta nga veprimi i vales goditese ne sipërfaqe

H&M MINING

PROJEKTE E KONSULENCE

BLLOKU"Vasil Shanto"

Rr. Viktor Eftimiu,P.1, Shk.5, Ap.2

Email:dhuro_caushi@yahoo.com

Percaktimi i largesise se sigurta nga veprimi i vales goditese ne siperfaqe eshte bere me formulen :

$$R_s = K_s Q^{0.5} \text{ ku:}$$

22. R_s -distanca e sigurte nga vala goditese ne metra
23. K_s - koeficient perpjestimor, madhesia e te cilit varet nga kushtet e vendosjes se ngarkeses dhe nga karakteri i demtimit, Vlera e tij per rastin tone eshte marre $K_s = 10$
24. Q sasia e L.P qe shperthen menjehere eshte pranuar $Q = 700 \text{ kg}$

Pas zevendesimeve $R_s = 10 \times 700^{0.5} = 265 \text{ m}$

2.Percaktimi i largesive sizmike te sigurta nga plasja

2.1 Percaktimi i largesise se sigurte sizmike sipas RTS per punet me lende plasese ne miniera dhe nafte (botim i vitit 2002 faqe 179 - 192)

Percaktimi i largesise sizmike te sigurta nga plasja eshte bere me formulen e meposhteme:

$$R_s = \alpha k_s x Q^{1/3} \text{ Ku:}$$

- Q - Sasia e ngarkeses se LP qe shperthen menjehere, eshte pranuar $Q = 700 \text{ Kg}$
- R_s - Largesia prej vendit ku behet plasja, ne m; zonat me rreze me te vogel se R_s , jane zona te rrezikshme zonat me rreze me te medha se R_s , jane zona te parrezikshme;
- α - Koeficienti qe varet nga treguesi i veprimit te plasjes per rastin tone $\alpha = 1.2$.
- K_s - Koeficienti qe varet nga vetite e tokes ne themelet e objekteve qe ruhen. Per rastin tone vlera e tij $k_s = 9$. Pas zevendesimeve do te kemi

$$R_s = \alpha k_s x Q^{1/3} = 1.2 \times 9 \times 700^{1/3} = 94 \text{ m} \approx 100 \text{ m}$$

2.2. Percaktimi i largesive sizmike ne varesi te shpejtesise se lekundjeve V_{max} ne mm/sek

Ne funksion te kushteve qe vendosin normat DIN dhe AFTES, te aplikueshme per te gjitha vendet e komunitetit European eshte bere llogaritja e shpejtesise maksimale te lekundjeve nga shperthimi i L.P me formulen e meposhteme :

$$V_{max} = K / (D/Q^{1/2})^{-1.8} \text{ Ku:}$$

25. V_{max} -Shpejtesie e lekundjeve ne mm/sek
26. D - Distanca nga vendi i shperthimit, ne metra
27. Q - Sasia e L.P qe shperthehet njeheresh 700 Kg
28. K – Koeficient qe mer ne konsiderate treguesit e masivit shkembor RQD, RMR, kompaktesine dhe shpejtesine e shperndarjes se vales lekundese ne m/sek - K merr vlerat $1200-6000$ dhe eshte pa njesi

Pas transformimeve ne formulen e mesiperme duke marre ne konsiderate:

H&M MINING

PROJEKTE E KONSULENCE

BLLOKU "Vasil Shanto"

Rr. Viktor Eftimiu, P.1, Shk.5, Ap.2

Email: dhuro_caushi@yahoo.com

29. $Q = 700\text{Kg}$

30. $RQD = 78-92\%$


31. RMR - E vleresuar indirekt sipas metodikes se Barton etj.

32. Shpejtesine e perhapjes se vales (1200m/sek –6000 m/sek)

33. V_{max} te lejuar per ndertesa nje kat me konstruksion te zakonshem 22.5mm/sek

34. V_{max} te lejuar per ndertime te rendesishme dhe rruge te klasit te pare 8 mm/sek

Per sasine e shperthimit prej 700 Kg kjo distance do te jete 275 m



3.Percaktimi i largesise se parrezikshme nga flakerimi i copave shkembore

Permasat dhe forma e zones se flakerimit te copave shkembore varet nga :

35. Sasia e ngarkeses se lendes plasese qe shperthen njeheresh ($Q_{max} = 700\text{ Kg}$)
36. Menyra e vendosjes se ngarkeses me lende plasese (ne siperfaqe, ne toke dhe nentoke)
37. Vlera e treguesit te veprimit te plasjes n
38. Kendi i flakerimit te copave ne raport me horizontin

H&M MINING

PROJEKTE E KONSULENCE

BLLOKU"Vasil Shanto"

Rr. Viktor Eftimiu,P.1, Shk.5, Ap.2

Email:dhuro_caushi@yahoo.com

- 39. Prania e pengesave natyrale mbrojtese, qe frenojne perhapjen e copave shkembore
- 40. Lloji i tokes ku kryen punimet me lende palsese (ne rastin tone toka shkembore)


Llogaritja e zones se flakerimit te copave eshte bere me formulen e meposhteme duke marre parasysh shperthimin e birave te shkurtra te minave si dhe te ndonje ngarkese te mbivendosur:

$$L=(V_0^2/2g) \sin\alpha\cos\alpha$$

Ku:

- 41. $\alpha = 45^\circ$ Kendi i fluturimit te copave per trajektoren maksimale;
- 42. $V_0=40-100$ m/s Shpejtesia fillestare e flakerimit te cop;
- 43. $g= 9.82$ m/s², Shpejtimi (nxitimi) i renies se lire

Per vlerat e dhena me siper distance e flakerimit te copave shkon nga 41 m per $V_0= 40$ m/s ne 255 m per $V_0 = 100$ m/s



Duke marre parsysh te gjithë faktoret e permedur me siper dhe ne baze te Rregullores se Tekniques se Sigurimit per Punet me Lende Plasese, pranojme distancen e parrezikshme 300m (Shiko vizatimin me zonat e rrezikshme)

H&M MINING
PROJEKTE E KONSULENCE
BLLOKU"Vasil Shanto"
Rr. Viktor Eftimiu,P.1, Shk.5, Ap.2
Email:dhuro_caushi@yahoo.com

PASAPORTA E SHPIM - PLASJES ME BIRA TE SHKURTRA DORE

Shkalla 1 : 50




Tabela e freqesave te rrezimit me bira te shkurtra minash

Nr	Emertimi	Simboli	Njesi	Vlera
1	Lartesia e shkallës	H	m	10
2	Lartesia e nenshkallës	h	m	2
3	Gjatësia e bires	h_b	m	2.2
4	Diametri i bires	ϕ	mm	38 - 42
5	Kendi i skarpates	α	grade	70 - 72
6	Distanca nga bira ne bira		m	1.5
7	Distanca nga buza e skarpates se sipërme ne bira	a	m	0.8
8	Distanca nga bira tek buza e skarpates se poshtme	c	m	1.2
9	Vija e rezistencës me te vogel	W	m	2.2
10	Ngarkesa e lendes plasese per bira		Kg	1.8
11	Volumi maksimal i hedhur per bira		m^3	6
12	Numri maksimal i birave ne nje shperthim		cope	deri 120
13	Menyra e shperthimit		Me zjarr ose elektrike	

H&M MINING
 PROJEKTE E KONSULENCE
 BLOKU "Vasil Shanto"
 Rr. Viktor Eftimiu, P.1, Shk.5, Ap.2
 Email: dhuro_caushi@yahoo.com

e. Infrastruktura e nevojshme per lidhjen me rrjetin elektrike, furnizimin me uje, shkarkimet e ujerave te ndotura dhe mbetjeve ,si dhe informacion per rruget ekzistuese te aksesit apo nevojen per hapje te rrugeve te reja

Infrastruktura e nevojshme per lidhjen me rrjetin elektrik.

Ne kete aktivitet nuk do te perdoren pajisje qe punojne me energji elektrike. Makinerite qe do te perdoren per shfrytezimin, ngarkimin dhe shkarkimin e mineralit punojne me motor Dizel.

Furnizimin me uje

Ne teknologjine e prodhimit te gurit gelqerore me kariere nuk perdoret uji.

Uji do te perdoret ne periudhe te thate per lagien e rrugeve te levizjes se mjeteve te transportit, lagien e ngarkesave te gurit gelqerore ne mjetet e transportit, dhe per sherbime vetiake nga personeli sherbimit ne kariere. Sasia e ujit do te jete minimale rreth 5m³ ne dite. Uje ne fazen e pare do te sigurohet me depozit qe do te furnizohet me autobot qe ka ne perdorim subjekti.

Nuk do te kete shkarkime te ujerave te ndotur. Nje nder arsytet qe nuk perdoret uje ne procesin e shfrytezimit eshte se guri gelqerorm e prezence uji ndotet sepse perzihet me dherat dhe e ben te papranueshme per perdorim. Uji do perdoret per lagien e territorit per paksimin e pluhurave ne stinen e thate , gjate procesit te nxjerrjes se gurit gelqerordhe do sigurohet permes depozitave nga shoqeria.

Tualeti i punetoreve eshte me grope septike.

Gjithashtu mbetjet e krijuara ne kariere nga veprimtaria humane e punonjesve ose nga proceset e punes do te trasportohen ne sheshin e depozitimit te miratuar nga pushteti vendor.

Rruget ekzistuese te aksesit apo nevoja per hapje te rrugeve te reja

Mbas marjes ne konsiderate te faktoreve te mesiperme eshte bere studimi i varianteve te hapjes se vendburimit dhe eshte konkluduar se ai mund te hapet nga ana e rruges automobilistike qe lidh fshatin Brar me qytetin e Tiranes

Nga verifikimi ne vend i varjnteve te mundshem per hapjen e objektit eshte pare e mundur qe fillimi i punes ne zone te realizohet nga rruga e hapur ne jug te fshatit Ferraj e cila ne gjithe gjatesine e saj eshte e hapur, pjeserish e asfaltuar dhe pjeserisht rruge gjysem e hapur e cila me pak shpenzime riparimi behet e mundur te perdoret per fillimin e punes Vetem rreth 200 metra rruge e re mbeet per tu hapur deri ne oobjekt dhe behet i mundur nisja e investimeve per objekte industriale,

Kjo rruge eshte rreth 4 km me e gjate se rruga tjeter ne krahun veriore te fshatit, eshte me e shkurter , por kerkon hapje te nje rruge te re

Pika e fillimit te transhese do te jete ne nje disatence te afert nga kufiri i karrieres 1-5 duke filluar nga pika "A" prane Ures se Brarit me koordinata y=4405050, X= 4584300 e cila pjeserish eshte e hapur

H&M MINING

PROJEKTE E KONSULENCE

BLLOKU"Vasil Shanto"

Rr. Viktor Eftimiu,P.1, Shk.5, Ap.2

Email:dhuro_caushi@yahoo.com

dhe pjesa ne nje gjatesi prej 400 m dhe me tej ne vijim do te hapet rruge e re me gjaresi 450 m deri ne nivelin e siperme te karrieres +342 duke prere izoipset e shkalleve te mesiperme

Gjatesia e rruges sipas ketij aksi nga niveli actual i saj deri ne kuoten +342 rezulton rreth 950m

Hapja e vendburimit deri ne kuoten +342m parashikohet te behet me nje rruge me gjeresi 6-m dhe pjerresi 12-14% . Gjatesia e pergjitheshme e kesaj rruge duke perfshire dhe kthesat parashikohet te jete rreth 1.0 km .

Projekti i hapjes se karrieres i bashkangjitet materjalit.

Disniveli midis kuotes se siperme dhe pikes me te poshteme eshte rreth 60 m.

Dyshemeja e kesaj transheje do te shtrohet me çakell qe do te prodhohet gjate hapjes se transhese se brendeshme.

Transheja e hapjes se brendeshme do te kaloje kryesisht ne formacione te forta, (gelqerore) prandaj hapja e saj do te behet me perdorimin e punimeve shpim-plasese dhe forces mekanike te kovës se eskavatorit dhe buldozerit.

Me lidhjen e rruges ne shkallen e siperme +342m ne kuoten me te siperme do te filloje hapja e transhese prerese ne ate shkalle dhe paralelisht me shfrytezimin ne te, do te vijoje te hapet kjo transhe nga larte –poshte duke filluar nga kuota +330 ne +320 pastaj ne kuoten +310e me radhe. Keto transhe do te hapen horizontale duke ndjekur izoipsin ne horizontin perkates. Gjeresia e ketyre transheve do te jete e njejte me ate te transhese kryesore (te hapjes) te brendeshme. Drejtimi i hapjes se transhese prerese do te jete nga lindja ne perendim dhe anasjelltas ne varesi te vendit te hapjes se saj nga transheja kryesore.

f. Programi per ndertimin, kohezgjatjen e ndertimit, kohezgjatja e planifikuar e funksionimit te projektit, kohen e mundeshme te perfundimit te funksionimit te projektit dhe faza e planifikuar per rehabilitimin e siperfaqes pas mbarimit te funksionimit te projektit.

Programi per ndertimin e karrieres perfshin:

<i>Nr.</i>	<i>Objektet</i>	<i>Kohezgjatja kohore</i>
1	Ndertimi brenda teritorit te karrieres te rruges hyrese	60 dite
2	Ndertimi i kanaleve perimetrike te sistemimit te ujerave te shiut	20 dite
3	Pergatitja e sheshit ku do te vendosen sterilet qe dodalinnga procesi i shfrytezimit	15 dite

Projekti ndertimor per hapjen e karrieres Ka perqellim lidhjen e fronteve te prodhimit te gurit gelqerore (te shesheve te shkalleve) me rrugen nacionale te transportit.

H&M MINING

PROJEKTE E KONSULENCE

BLLOKU"Vasil Shanto"

Rr. Viktor Eftimiu,P.1, Shk.5, Ap.2

Email:dhuro_caushi@yahoo.com

Hapja e vendburimit eshte projektuar ne menyre qe shfrytezimi i gurit gelqeror ne kariere te behet nga lart poshte. Per hartimin e projektit te ndertimit te rruges automobilistike ne kariere jane marre ne konsiderat parametrat si vijon:

- Lartesine e projektuar te shkalleve te karieres
- Elementet e shtrirjes dhe renies se depozitimeve te gurit gelqerore ne zonen e projektuar.
- Siperfaqja e zones se projektuar.
- Vetite fiziko – mekanike te shkembinjve
- Kushtet klimaterike dhe hidrogjeologjike te rajonit ku kryhet aktiviteti.
- Relievi
- Lloji transportit qe parapelqen investitori, makinerit e shpimit te birave me sonde dhe ngarkimit te prodhimit ne sheshin e shkalleve.
- Sasia e rezervave te vendburimit qe do te aktivizohen.
- Prodhimi nder vite i projektuar.

Jetegjatesia e aktivitetit te shfrytezimit te gurit gelqeror do te percaktohet ne lejen minerare qe do te marr subjekti.

Masat rehabilituese

Punimet qe do te kryen per rehabilitimin e zones se shfrytezuar

- Punime inxhinierike
- Punime biologjike

-Punime inxhinierike

- Hapja dhe mirembajtja e rrugeve automobilistike per hyrje ne sheshin e sigurise se shkalleve
- Hapja e kunetave dhe kanaleve per drenazhim dhe disiplinimin e ujerave te rreshjet atmosferike

-Punime biologjike

- Mbushja me dhera humusore me trashesi 30cm te shesheve te shkalleve dhe pergatitja e tokes per mbjellje me bimesi.
- Mbjellja e fidaneve qe rriten ne kete zone
- Mbjellja e bimesise.
- Sherbimet profilaktike ne siperfaqet e rehabilituara.

-Ana bologjike

Zona eshte me depozitime gure gelqerori qe nuk kane bimesi shume te zhvilluar.

Ndryshueshmeria biologjike e zones kushtezohet nga veprimi i klimes mesdhetare. Ne kete zone eshte prania e shkurreve mesdhetare.

Bimesia drunore e larte ne formen e pyjeve pothuajse mungon dhe dominohet nga llojet e shkurreve mesdhetare.

Gjitaret e medhej qe takohen ne kete zone jane dhelpra, lepuri i eger numri i te cilit eshte zvogeluar , nusja e lales etj

Nga shpendet me shpesh takohen thelleza, trumcaket, gushkuqietj. Gjithashtu takohen zvarranik te ndryshem si gjalperinj, hardhuca, breshka, nje numer i pakufizuar insektesh, milingona, etj.

H&M MINING

PROJEKTE E KONSULENCE

BLLOKU"Vasil Shanto"

Rr. Viktor Eftimiu,P.1, Shk.5, Ap.2

Email:dhuro_caushi@yahoo.com

Rehabilitimi zones se shfrytezuar duke u gjelberuar dhe pyllezuar do te permiresoje cilesine e ajrit floren dhe faunen e zones, etj. Mbas rehabilitimit te çdo sheshi do te kryhen te gjitha sherbimet e nevojshme per mbirjen dhe mirembajtje te tyre.

Ne teresi, ne funksionimin e ekosistemeve te tjera nisur nga koncepti i teresise ekologjike keto habitate kane vlera dhe duhet te ruhen dhe rehabilitohen.

Flora dhe vegetacioni i kesaj zone dominohen nga shkurre te egra. Ne kete kat shkurre ka si mbulesa ne masen me te madhe te tij bimesia barishtore qe zhvillohet ne varesi te drejtperdrejte te mikroklimave dhe eshte rezultat i veprimtarise antropogjene.

-Punime biologjike biodiversiteti

Ndryshuesmeria biologjike e zones kushtezohet nga veprimi klimave mesdhetare.

Ne kete zone eshte prania e bimesise mesdhetare te shkurreve te ulta dhe barishteve si dhe te ferrave . Bimesia e larte ne fomen e pyjeve masive mungon dhe dominohet nga llojet e siperpermendura dhe dushknajat qe jane deshmitare te pranise se tyre masive ne te kaluaren.

Nisur nga koncepti i teresise ekologjike keto habitate kane vlera dhe duhet te rehabilitohen.

Per kete ne zonen e kryerjes se punimeve do te mbillet bimesia e zones dhe bimesi e kultivuar ne te gjitha sheshet e sigurimit qe do te dalin per cdo horizont shfrytezimi.

Pervec filizave do te mbillen edhe bimet barishtore ne sheshet e shkalleve per te krijuar siperfaqe te gjelber. Mbjellja e tyre do te permiresoje ne menyre te dukshme pejsazhin e zones dhe do te ndikoj ne rritjen e popullimit dhe numrit te gjitareve, shpendeve dhe zvarranikeve, sepse do te krijohen kushtet e nevojshme per zhvillimin e tyre, te folezimit dhe do te eliminohet fenomeni i erozionit.

Punimet e rehabilitimit konsistojne si me posht.

-Krijimin e siperfaqeve per mbjellje

-Sistemimin e materialit te mbuleses te depozituar paraprakisht ne kufijte e karrieres.

-Mbjelljen e siperfaqeve te reja me shkurre te egra dhe drure te zones mesdhetare

-Mirembajtjen e siperfaqeve te mbjella.

Masat zbutese te ndikimeve negative gjate procesit te shfrytezimit.

Masat zbutese te ndikimeve negative konsistojne ne uljen e ndotjeve gjate punimeve ne kariere te ajrit nga pluhuri, gazet mbrojtja nga zhurma,si dhe uljen e efekteve negative hapsinore dhe ne territor, ne faunen dhe floren.Por pikesynimi kryesor i studimit mbetet rehabilitimi i tokes dhe evitimi ne maksimum i erozionit.

Masat konkrete qe do te merren gjate punimeve do te jene :

-Mbjellje me filiza te bimesise se zones se gjithe periferise me te larte te shpatit te territorit gjate shfrytezimit. Kjo mase do te sherbeje edhe per uljen e nivelit te pluhurave dhe zhurmave ne vazhdim te projektit, si dhe te rrishte mundesimin per vetegjenerim te drureve ne pjesen e larte me shpatin tjetër te kodres.

-Pemiresimin e bimesise ne te gjitha periferine e karrieres me bimesi te zones si dellinje dhe makje per te izoluar pjesen e fragmentizuar nga shfrytezimi prej atyre te paprekura nga projekti duke lene mundesine per perhapje te metejshme te ketyre specieve vendase ne territoret fqinje.Te dy keto masa mund te sherbejne si bariera per pluhurin qe mund te nxirret nga aktiviteti eolik gjate shfrytezimit.

H&M MINING

PROJEKTE E KONSULENCE

BLLOKU"Vasil Shanto"

Rr. Viktor Eftimiu,P.1, Shk.5, Ap.2

Email:dhuro_caushi@yahoo.com

-Uljen e prodhimit per stinen e veres duke evituar keshtu me sa te jete e mundur pluhurat. Nga ana tjeter per te ulur efektet negative, gjate periudhave te thata do te perdoret lagia e shesheve te punes dhe sidomos,lagia e materialit te nxjere. Kjo do te mbroje ambjentin nga pluhuri gjate transportit te prodhimit

Rehabilitimi i territorit

Masat rehabilituese do tekonsistojne ne :

- Uljen e erozionit
- Restaurimin e habitateve
- Pasurimin e biodiversitetit me speciet natyrore.
- Rritjen e vlerave vizuale dhe rikrijuese te territorit qe do te shfrytezohet.

Se pari shfrytezimi me tarace me lartesi 10 m, eshte bere per te lehtesuar zbatimin e planit te rehabilitimit. Keto taraca do te lejojne si mbulimin e siperfaqes me gjelberim ashtu edhe evitimn e pamjeve te pakendeshme te shpateve vertikale te tarracave qe mund te mbeten zbuluar ne rastet e lartesis se pergjithshme te tarraces rreth 10 m.

Rradha e mbjelljeve do tejete nga lart-poshte, duke lejuar mundesine per vetepershapjen e specieve mbi bazat eaktivitetit eolitik dhe forces se rendeses. Gjeresia e shkalles se taraces do te jete 4m. Kjo lloj mbjellje lejon vetepershapjen e species, si dhe nuk demton ne rritjen e bimeve pasi nuk pengon dritezimin.

Rehabilitimi i tokes

Per rehabilitimin e tokes, do te shfrytezohen mbetjet e imeta nga materiali i nxjerre dhe do te plotesohet me dhera humusore te pasur me pleh.

Nese do te nevojitet stabilizimi i ketij dheu nje pjese e faqes se pjerrret do te behet me trungje te ngulura me thelesi 30 cm, mulcirimi do te jete i thate dhe me kashte, gjethe te bimeve te zones dhe dege. Mulcirimi do tesherbeje si per uljen e humbjeve te farnave nga largimi prej aktivitetit eolik, ashtu dhe per uljen e aktivitetit erodik per sa kohe vegetacioni eshte i pa zhvilluar mire. Mbjelljet do te kene renditjen me largesi fidanesh cdo 10 m, gje qe do ti jape nje kurore dendesi mjaft e mire territorit pas shfrytezimit, dhe lejon dritezimin per veterritjen dhe zhvillimin e bimeve natyrore.

Rehabilitimi i plote i mjedisve te territorit do te jete si me poshte:

Mbjellja e tarracave

- Mbjellje e taracave ne shkallet e karieres
- Filiza 2 vjecare ne periferi
- Mbjellje e filizave 2 vjecare te pemeve dhe lejimi i perteritjes se shkurreve.

Nga vete rehabilitimi i habitateve me perparasi do te marre rritja e abudances se shpendeve dhe zvarranikeve dhe njekohesisht do te shtohen si habitatet ashtu dhe rezervat natyrore edhe per gjitaret e larte si lepuri etj. prej ketej do te rritet edhe mundesia e pranise se mishngrenesve te larte si dhelpra ,etj.

Kanalet dhe kunetat.

Kunetat dhe kanalet do te bejne qe rrjedhja e ujrave siperfaqesore te behet me force rendese, duke perftuar ne kete menyre grumbullimin e tyre dhe me pas depertimin gradual ne toke.

H&M MINING

PROJEKTE E KONSULENCE

BLLOKU"Vasil Shanto"

Rr. Viktor Eftimiu,P.1, Shk.5, Ap.2

Email:dhuro_caushi@yahoo.com

Kombinimi i punimeve të shfrytëzimit të karrierës me ato të zbutjes së impakteve mjedisore si dhe punimet rehabilituese, do të ketë si pasoje edhe rritjen e numrit të të punësuarve. Kujdesi për punimet rehabilituese nga ana e shoqërisë do të vazhdojë të paktën deri në katër vite pas mbarimit të shfrytëzimit të karrierës.

-Krijimi i sipërfaqeve për mbjellje, sistemin, grumbullimi dhe mbjellja.

Për të krijuar sipërfaqet për mbjellje, shkurrësh ose barishtesh të zonës, subjekti parashikon që në vitin e parë të bëjë:

Sistemin i dherave në taracat e shesheve të shkalleve për të gjithë sipërfaqen që do të shfrytëzohet. Ndryshimet e mundshme në ritmet e prodhimit do të reflektohen edhe në planin e rehabilitimit.

-Punimet e mbylljes trajtimit të sterile dhe rehabilitimit të zonës

Elementet e mesipër janë marrë në konsideratë në hartimin e projektit të mbylljes dhe llogaritjen e shpenzimeve përkatëse për realizimin e tij dhe përkatësisht:

-Zonat e shfrytëzuara të krijuara nga shfrytëzimi do të mbushen me sterilet e depozituara përreth tyre dhe me vone do të mbulohen me dhe aktiv për të mundësuar mbjelljen e pemëve të përshtatshme të zonës.

-Do të çmontohen pajisjet

-Në përfundim do të jetë i shoqëruar nga sinjalistika përkatëse edhe rrethimi

-Preventivi i shpenzimeve të rehabilitimit të sipërfaqes së shfrytëzuar dhe llogaritja e garancive në vit

Plani përfundimtar i mbylljes dhe rehabilitimit mjedisor pas përfundimit të aktivitetit mineral të shfrytëzimit të mineralit gelqerorit në zonën minerarë të shfrytëzimit nr 121/7, hartohet në zbatim të Udhëzimit Nr 718, datë 03.10.2011 “Për mënyrën e vlerësimit të garancive financiare të lejeve minerare”

Aneksi 4 “Mënyra e vlerësimit të garancive për realizimin e planit të rehabilitimit për lejet minerare të shfrytëzimit dhe kërkim-zbulim shfrytëzimit”

Pika 1 Për shfrytëzimin nëntokësor në pikë a, Preventivi tip i planit të rehabilitimit të një miniere nëntokësore të hapur me punime horizontale dhe të pjerrta.

Pika 2 Për shfrytëzimin sipërfaqësor, në pikë a Preventivi tip i planit të rehabilitimit të një 1 ha kariere për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyreve, bitumeve dhe mineraleve radioaktive të çmuar dhe gjysem të çmuara.

Në tabelat e mëposhtme janë dhënë llogaritjet përkatëse për realizimin e të gjitha proceseve përkatëse të parashikuara në preventivin tip

1. Shpenzimet për mbylljen dhe rehabilitimin e 1 ha kariere për pjesën e shfrytëzuar me sipërfaqe rezultojnë 322 750 leke/ha

H&M MINING

PROJEKTE E KONSULENCE

BLLOKU “Vasil Shanto”

Rr. Viktor Eftimiu, P.1, Shk.5, Ap.2

Email: dhuro_caushi@yahoo.com

"FERRAJ" SH.P.K

2. Ne sipërfaqen e përgjithshme horizontale që do të trajtohet është marrë në konsideratë:
3. Sipërfaqja e karrieres së prekur nga shfrytëzimi i deritanishëm 3.51 ha;
4. Sipërfaqe e prekur nga rruga rruga është 0.13 hektare
5. Sipërfaqe e stoqeve të sterileve 0.25
6. Gjithësej sipërfaqe e prekur 3.89 hektare
- ✚ Sipërfaqja që do të preket nga shfrytëzimi në fund të afatit ligjor 4.66 ha;

Shpenzimet për mbylljen dhe rehabilitimin e sipërfaqes së prekur 3.89×322750 leke/ha = 1 255 497 leke

Shpenzime për demolimin e Impiantit të sterileve 240379 leke

7. Shuma totale për mbyllje dhe rehabilitim të objektit 1 495 876 leke
8. Garancia vjetore e mjedisit 59 835 leke

Preventivi i shpenzimeve dhe llogaritja e garancisë për mbyllje dhe rehabilitim

Tabela e shpenzimeve për mbylljen dhe rehabilitimin e 1 Ha

Preventivi i planit të rehabilitimit të pjesës së karrieres të shfrytëzuar									
Nr	Operacionet	Sipërfaqja	Norma	Sipërfaqe	norma	Volumi I punës	Çmimi	Vlera	
			ha/ha	operacionale	m ³ /ha oper	m ³	Leke/m ³	Leke	
I	Plani I mbylljes së Karrieres								
Nr	Emertimi								
a	Krehje sistemim ifaqeve anësore	1	1.5	1.5	200	300	50	15000	
	Shuma I .								15000
II	Plani I menaxhimit të mbetjeve								
a	Sistemimi I mbetjeve të zbulimit	1	0.6	0.6	2000	1200	20	24000	
b	Sistemimi I mbetjeve teknologjike	1	0.25	0.25	2000	2000	20	40000	
	Shuma II								64000
III	Plani i rehabilitimit të mjedisit								
					nr/ha	nr			
a	Mbushje me dhe e sipërfaqes	1	0.5	0.5	2500	1250	35	43750	
b	Mbjellje pemesh	1	0.5	0.5	300	150	100	15000	
c	Hapje gropash	1	0.5	0.5	300	150	1000	150000	
d	Blerje pemesh	1	0.5	0.5	300	150	50	7500	


H&M MINING
PROJEKTE E KONSULENCE
BLLOKU "Vasil Shanto"
Rr. Viktor Eftimiu, P.1, Shk.5, Ap.2
Email: dhuro_caushi@yahoo.com

"FERRAJ" SH.P.K

e	Sherbime	1	0.5	0.5	300	150	50	7500
f	Kanali I ujrave te larta		Norm a		gjatesi	Volumi	Çmi mi	Vlera
			ml/ha		ml	m3	leke/ m3	leke
		1	300		300	75	200	15000
g	Sinjalistike							5000
	Shuma (a-g)							243750
	Shuma (I+II+III)							322750
	TOTALI							322750


H&M MINING
PROJEKTE E KONSULENCE
BLLOKU "Vasil Shanto"
Rr. Viktor Eftimiu, P.1, Shk.5, Ap.2
Email: dhuro_caushi@yahoo.com

FERRAJ SH.P.K



H&M MINING
PROJEKTE E KONSULENCE
BLLOKU "Vasil Shanto"
 Rr. Viktor Eftimi, P.1, Shk.5, Ap.2
 Email: dhuro_caushi@yahoo.com

"FERRAJ" SH.P.K



H&M MINING
PROJEKTE E KONSULENCE
BLLOKU "Vasil Shanto"
 Rr. Viktor Eftimiu, P.1, Shk.5, Ap.2
 Email: dhuro_caushi@yahoo.com

"FERRAJ" SH.P.K

Fazat e planifikuara te reabilitimit te karieres pas mbarimit te funksionimit te projektit

Nr.	Emertimi	Vitet
1	Ndertim kunetash , kanale kullimi uji, sistemim skarpate dhe sheshe shkalle	Vitin e I deri vitin e III
2	Furnizim vendosje, shtrim te dherave humusore ne sheshet e shkalleve, hapje gropash	Ne vitin e III ^{te} dhe 2 muaj mbas vitit te trete
3	Mbjellje te shesheve te shkalleve me bar dhe bimesi	Nga vitin e III ^{te} 2 muaj mbas vitit te trete
4	Sherbim te zones se reabilituar zevendesim te bimeve te demtuara	Nje vit mbas mbylljes se aktivitetit minerar

g. menytrat dhe metodat qe do te perdoren per ndertimin e objekteve te projektit

1-Ndertimi i trasese se rruges ne teritorin e karieres do tebehet me metoden e coptimit te gurit gelqerore me matrapik te montuar ne krahun e eskavatorit.Trasea e rruges te ndertohtet ne teritorin e lejes minerare.

h. lendet e para qe do te perdoren per ndertimin dhe menyra e sigurimit te tyre (materiale ndertimi, uje dhe energji)

Per ndertimin e rruges se hapjes se karieres dhe shfrytezimit te gurit gelqerore ne kariere do te perdoren makinerit, si: eskavator me zinxhira, kamione transporti me motora dizel qe punojne me karburant (Dizel).

Karburanti do te furnizohet nga subjekte te licencuara per import, ruajtje dhe tregtim te karburanteve ne Republiken e Shqiperise.Ndersa per mbrojtjen nga pluhuri, per nevoja vetiake dhe nga punonjesit, mbrojtjen nga zjarri dhe sherbime te tjera do te perdoret uje. Uje do te sigurohet me autobot nga vet shoqeria.

Lendet e para ndihmese qe do te perdoren ne kariere jane:

- Naftë dhe Vajra lubrifikant për mjetet e punës
- Uje per perdorim vetjak dhe sperkatje per eliminimin e pluhurave
- Panele Sanduici te gatshme qe do sherben si objekte sherbimi per zyra , garderobe etj
- Lende plasese per perdorim civil

Kosto e prodhimit per 1 m³

Nr	Emertimi	Njesia	Norma	Çmimi	Vlefte Lek /m3
1	Materiale Ndhmese				136.61
	Amonit	kg/m3	0.35	240	84.00
	Kapsolla elektrike	cope/m3	0.012	25	0.30
	Tel linje	ml/m3	0.015	20	0.30
	Karburant	litra/m3	0.22	140	30.80
	Lubrifikant	litra/m3	0.011	250	2.75
	Pajisje shpimi	cope/m3	0.016	1000	16.00
	Pjese ndrimi +goma etj	lek /m3			2.46
2	Pagat direkte	lek /m3			60.48
3	Shtesat mbi paga 21.7%	lek /m3			13.12

H&M MINING

PROJEKTE E KONSULENCE

BLLOKU"Vasil Shanto"

Rr. Viktor Eftimiu,P.1, Shk.5, Ap.2

Email:dhuro_caushi@yahoo.com

"FERRAJ" SH.P.K

4	Shpenzime te firmes	lek /m3		1.80
5	Shpenzime per mjedisin	lek /m3		1.15
6	Kosto pa amortizim	lek /m3		215.62
7	Amortizimi	lek /m3		21.12
8	Kosto operacionale	lek /m3		236.75

g. informacion per lidhjet e mundshme te projektit me projekte te tjera ekzistuese perreth/prane zones se projektit

Perreth zones ku do te zhvillohet aktiviteti nuk zhvillohet ndonje projekt qe te kete lidhje me te. Zona nuk njihet si zone ku zhvillohen aktivite industriale. Ne zone ushtrojne aktivitetin edhe kariera te tjera.

j. informacion lidhur me alternativat e marra ne konsiderate persai takon perzgjedhjes se vendodhjes se projektit dhe teknologjise qe do perdoret

Theksojme per organet vendim marrese, se mundesia e alternativave te marra ne konsiderat per perzgjedhjen e vendodhjes se projektit nga subjektet minerare ne teresi jane ne nivelin zero per keto arsye:

- Zona minerare dhe objekti percaktohet nga MEI me propozim te AKBN dhe shpallet ne planin tre vjecar dhe nji vjecar te Ministrise.
- Investitoret qe kryejne aktivite minerare jane para nje fakti te kryer per pjesmarrje ne tender te zonave minerarte te shpallura per konkurim.

Subjekti "Ferraj" sh.p.k eshte shpallur fitues i se drejtes per leje minerare shfrytezimi dhe me shkrese te MIE eshte njoftuar si i till

Sa me siper nuk eshte marr alternative tjeter per zhvillimin e aktivitetit per faktin se zona ka rezerva dhe subjekti ka investuar ne kete zone.

k. Perdorimin e lendeve te para gjate funksionimit, perfishire sasite e ujit te nevojshme , energjise, lendeve djegese dhe menyren e sigurimit te tyre

Ky aktivitet eshte aktivitet shfrytezimi i cili konsiston ne nxjerrjen e gurit gelqeror pra nuk perdor lende te para por siguron lende te pare per industrine e ndertimit. Uji perdoret vetem ne rastet per lagien e territorit ne menyre qe te mos kete krijim te pluhurave gjate veprimtarise sidomos ne kohe te thate dhe me ere, kjo sasi uji sigurohet permes depozitave te ujit qe shoqeria siguron per kete qellim. Lendet djegese qe perdorin mjetet e transportit sigurohet ne pikat e furnizimit me karburant te licensuara per tregtimin e tij.

Lendet e para ndihmese te konsumuara per prodhim gur gelqeror te projektuar jane:

H&M MINING
PROJEKTE E KONSULENCE
BLLOKU"Vasil Shanto"
Rr. Viktor Eftimiu,P.1, Shk.5, Ap.2
Email:dhuro_caushi@yahoo.com

- Nafta sasia e nevojshme 0.22litra/m³ mineral
- Vajrat lubrifikante sasia e nevojshme 0.011litra/m³ mineral
- Uje 50m³ per te lagur nje siperfaqe 5000m²
- Amonit 0.35 kg/m³

l. Aktivitete te tjera qe mund te nevojiten per zbatimin e projektit , si ndertim i kampeve apo rezidencave etj.


Zhvillimi i projektit nuk kerkon ndertimin e kampeve per qendrimin e punetoreve gjate kohes se shfrytezimit sepse numri i te punesuarve nuk eshte aq i madh sa per te ndertuar keto kampe per fjetje apo mensa sherbimi dhe gjithashtu nje pjese e te punesuarve jane nga zona perreth vendburimit qe do te shfrytezohet dhe punojne vetem me nje nderese ne dite.

Vepra inxhinierike qe do te ndertohen ose zgjerohen per shfrytezimin e gurit gelqerore nuk do te kete. Teknologjia e shfrytezimit te gurit gelqerore eshte e thjeshte konsiston ne coptimin e tyre, ngarkimin dhe transportindrejt destinacionit te kerkuar. Shfrytezimi do te behet ne siperfaqe me kariere.

m. Informacion per lejet dhe licensat e nevojshme per projektin te kerkuara nga legjislacioni ne fuqi si dhe institucionet kompetente per lejimin/licensimin e projektit

Shoqeria duhet te pergatise dokumentat per pajisjen me Leje Minerare per shfrytezimin e gurit gelqerore dhe shqyrtimin e dosjes nga AKBN-ja per pajisjen me leje shfrytezimi. Pjese e procedures per marrjen e lejes minerare eshte edhe pajisja me Deklarate Mjedisore si dhe Leje Mjedisore e Tipit B nga Ministria e Mjedisit.

k. kopje te lejeve, autorizimeve dhe licencave qe disponon zhvilluesi per projektin e propozuar , ne perputhje me percaktimet e bera ne legjislacionin ne fuqi, si dhe institucionet kompetente per lejimin/autorizimin/licencimin e projektit.


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN E MINIERAVE
DHE INDUSTRIË

Nr. 4793/Prot. /2 Tiranë, më 10/082020

Lënda: Njoftim Fituesi

SHOQËRISË "FERRAJ" SH.P.K ✓
Rruga e Brrarit, Njësia Administrative Dajt, Tiranë

Nr. i Referencës: Zona Minerare Nr. 121/7, për objektin Ferraj, Qarku Tiranë, lloji mineralit gur gëlqeror, veprimtaria shfrytëzim, e miratuar në planin vjetor minierat të vitit 2019.


Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë lajmëron shoqërinë "FERRAJ" sh.p.k me NUIS K52302013A, me adresë: Rruga e Brrarit, Njësia Administrative Dajt, Tiranë, se oferta e paraqitur më datë 28.05.2020, për përfitimin e të drejtës për aplikimin për leje minerare në zonën minerare nr. 121/7, për vlerën totale të investimit prej 26 000 000 [njëzetë e gjashtë milion] lekë dhe sasinë e prodhimit të mineralit gur gëlqeror 25 000 [njëzetë e pesë mijë] m³/vit, është pranuar si ofertë e suksesshme në procedurën e konkurrimit për të drejtën e aplikimit për leje minerare në zonën minerare konkurruese nr. 121/7, për objektin Ferraj, Qarku Tiranë, lloji mineralit gur gëlqeror, veprimtaria shfrytëzim, me kushtet që projekti i zhvillimit të veprimtarisë minerare që paraqitet me aplikimin në QKB duhet të përcaktojë:

• Prodhimi që mendohet të realizohet në zonën minerare	25 000 m ³ /vit
• Sasia e prodhimit që do të përpunohet	25 000 m ³ /vit
• Vlera e investimit që parashikohet për tu kryer	26 000 000 lekë
• Vlera e produkteve minerare	431 200 000 lekë
• Vlera e rentabilitetit ekonomik (IRR=....%)	63.66 %

Ofertuesi shoqëria "FERRAJ" sh.p.k kërkohet t'i paraqesë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Rr. "Abdi Toptani" Nr. 1 - Tiranë:

- Kopjen e vënies në dëjani për Formularin e Njoftimit, të nënshkuar.
- Në rast se tërhiqeni nga aplikimi për lejen minerare duhet të njoftoni me shkrim jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të këtij njoftimi.

KRYETARI I AUTORITETIT KONTRAKTUES
Betinda Baluku



Adresa: Rr. "Abdi Toptani", Nr. 1 Tiranë, Faqja Web: <http://www.infrastruktura.gov.al>

FORMULARI I PUBLIKIMIT TË NJOFTIMIT TË SUBJEKTIT FITUES

1. Autoriteti Kontraktues

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Adresa Rr. "Abdi Toptani", Nr. 1, Tiranë
Internet: www.infrastruktura.gov.al

2. Lloji i autoritetit kontraktues dhe aktiviteti ose aktivitetet kryesore:

Institucion Qendror	Institucion i Pavarur
X	<input type="checkbox"/>
Njësitë e Qeverisjes Vendore	Tjetër
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

3. Objekti i Procedurës konkurruese

Për dhënie e të drejtës për aplikim për leje minerare në Qendrën Kombëtare të Biznesit për zonën minerare konkurruese nr. 121/7.

4. Vendndodhja e objektit të Procedurës konkurruese

Objekti: Ferraj, Qarku Tiranë

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

Bazuar në ofertën e paraqitur në procedurën konkurruese nga shoqëria "FERRAJ" sh.p.k, rezulton se: Prodhimi që mendohet të realizohet në zonën minerare është 25 000 m³/vit; Sasia e prodhimit që do të përpunohet 25 000 m³/vit; Vlera e investimit që parashikohet për tu kryer 26 000 000 lekë; Vlera e produkteve minerare që parashikohet të merren nga veprimtaria minerare në zonën minerare 431 200 000 lekë; Vlera e rentabilitetit ekonomik (IRR=....%) parashikohet 63.66 %.

Numri i ofertave të dorëzuara: 1; Numri i ofertave të rregullta: 1

5. Referenca e dosjes, e përcaktuar sipas autoritetit kontraktues:

Nr. i Referencës së zonës minerare: Zona Minerare Konkurruese nr. 121/7, për objektin Ferraj, Qarku Tiranë, lloji mineralit gur gëlqeror, veprimtaria shfrytëzim, e miratuar në planin vjetor minerar të vitit 2019.

6. Emri dhe adresa e subjektit fitues

Emri "FERRAJ" sh.p.k
Adresa Rruga e Brrarit, Njësia Administrative Dajt, Tiranë

E-mail

Adresa e Internetit

7. Vlerat e investimit, prodhimit përfundimtar të ofertës:

Vlera e investimit	(pa TVSH) -monedha në lek
26 000 000	lekë
Sasia e prodhimit	(në ton/m ³ %)
25 000	m ³ /vit

8. Publikime të mëparshme, lidhur me të njëjtën kontratë (nëse zbatohet):

Nuk zbatohet

Buletini i Njoftimeve Publike	Data	17.03.2020	Numri	12
Buletini i Njoftimeve Publike	Data	14.04.2020	Numri	19

9. Informacione shtesë

Nuk ka

Data e shpërndarjes së këtij njoftimi/.../2020

"FERRAJ" SH.P.K



H&M MINING
 PROJEKTE E KONSULENCE
 BLOKU"Vasil Shanto"
 Rr. Viktor Efimiu,P.1, Shk.5, Ap.2
 Email:dhuro_caushi@yahoo.com

RAPORTI TEKNIK U PERGATITE NGA

“ H&M MINING” PROJEKTE E KONSULENCE

Ekspert Mjedisi Ing. Minere Adhurim CAUSHI

Ing. Gjeologj Thanas LLAHANA

Ing markshajder Lavdrim SARAÇI



H&M MINING
PROJEKTE E KONSULENCE
BLLOKU"Vasil Shanto"
Rr. Viktor Eftimiu,P.1, Shk.5, Ap.2
Email:dhuro_caushi@yahoo.com